Lemë 1. Në qoftë se funksioni f është i vazhdueshëm në intervalin I dhe plotëson mosbarazimin (3), atëherë ai plotëson edhe mosbarazimin (2), d.m.th. f është funksion konveks.

Një vërtetim interesant i këtij fakti gjendet në [6].

3. POHIME TË MIRËNJOHURA PËR FUNKSIONET KONVEKSE

Në qoftë se $f: I \rightarrow \mathcal{R}$ është funksion konveks, atëherë funksioni f ka këto cilësi:

(P_1) Ekzistojnë derivatet e pjesshme $f'_-(x)$ e $f'_+(x)$, të cilat janë të fundme në çdo pikë $x \in I$.

Funksionet f'_- dhe f'_+ janë monotone jozvogëluese në I , ndërkohë derivati i djathtë është i vazhdueshëm nga e djathta, ndërsa derivati i majtë është i vazhdueshëm nga e majta (shih [2] ose [8]).

(P_2) Bashkësia e pikave ku funksioni f nuk është i derivueshëm është e numërueshme (shih [2] ose [8]).

(P_3) Në qoftë se $[a, b] \subset I$ dhe $M = \max\{f'_+(a); f'_-(b)\}$, atëherë për çdo dy pika x dhe y nga $[a, b]$ është i vërtetë mosbarazimi

$$|f(x) - f(y)| \leq M|x - y|$$

që do të thotë se funksioni f plotëson kushtin e Lipschitzit (Lipschitz) [8].

Lemë 2. Në qoftë se funksioni $f: I \rightarrow \mathcal{R}$ është konveks, atëherë derivati f' është i vazhdueshëm në I , me përjashtim ndoshta të një bashkësie të numërueshme pikash të këtij intervali.

Vërtetim. Në saje të pohimit (P_2) derivati f' ekziston në I , me përjashtim ndoshta të një

bashkësie të numërueshme pikash $E = \{x_1, x_2, \dots\}$. Për $x \in I \setminus E$ është i vërtetë barazimi

$$f'_-(x) = f'_+(x) = f'(x)$$

Meqenëse funksioni f'_- është i vazhdueshëm nga e djathta dhe funksioni f'_+ është i vazhdueshëm nga e majta (pohimit P_1), rrjedh se derivati f' është funksion i vazhdueshëm edhe nga e majta edhe nga e djathta në $I \setminus E$, që do të thotë se ai është i vazhdueshëm në $I \setminus E$.

4. PARAQITJA INTEGRALE E FUNKSIONIT KONVEKS

Le të jetë $f: I \rightarrow \mathcal{R}$ i përcaktuar në një interval I dhe $a \in I$ një pikë e fiksuar.

Teoremë 1. Kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm që funksioni f të jetë konveks në intervalin I është që për çdo $x \in I$, ky funksion të paraqitet në trajtën

$$f(x) = C + (\mathcal{R}) \int_a^x g(t) dt \quad (4)$$

ku g është funksion jozvogëlues në I dhe C konstante reale (në fakt, $C = f(a)$).

(Simboli (\mathcal{R}) para shenjës së integralit tregon integrim sipas Rimanit, të cilin, gjatë vërtetimit, nuk do ta shkruajmë, por do ta nënkuptojmë.)

Vërtetim

► **Të vërtetojmë që kushti (5) është i domosdoshëm.** E zëmë se f është konveks në I . Në bazë të lemës 2 bashkësia e pikave të këputjes të funksionit f' ka masën (sipas Lebegut) zero. Në teorinë e integralit të Rimanit (shih p.sh. [3]) provohet se:

- Derivati f' është i integrueshëm sipas Rimanit atëherë dhe vetëm atëherë kur bashkësia e pikave të këputjes së tij, e cila është e tipit F_σ , ta ketë masën sipas Lebegut të barabartë me zero.

- Çdo funksion $f: [a, b] \rightarrow \mathcal{R}$ që e ka derivatin f' të integrueshëm sipas Rimanit në segmentin $[a, b]$, është integral i pacaktuar i derivatit të vet:

$$f(x) = f(a) + \int_a^x f'(t) dt \quad (a \leq x \leq b) \quad (5)$$

Formula (6) është e vërtetë edhe kur $b < a$, d.m.th. është e vërtetë në një segment të përgjithësuar $[a,b]$. Meqenëse çdo pikë $x \in I$ mund ta përfshijmë në një segment të përgjithësuar $[a,b]$, të tillë që $[a,b] \subset I$, barazimi (6) është i vërtetë për çdo $x \in I$.

Po të zëvendësojmë në këtë formulë derivatin $f'(t)$ me derivatin e djathtë $f'_+(t)$, formula (5) merr trajtën

$$f(x) = f(a) + \int_a^x f'_+(t) dt \quad (x \in I) \quad (6)$$

ose

$$f(x) = C + \int_a^x g(t) dt \quad (x \in I) \quad (7)$$

ku, sipas pohimit (P_1), funksioni $g(t) = f'_+(t)$ është jozvogëlues, ndërkohë $C = f(a)$.

► **Të vërtetojmë që kushti (5) është i mjaftueshëm.** E zëmë se për funksionin f është i vërtetë barazimi (5). Meqenëse integrali i

pacaktuar $(\mathcal{R}) \int_{x_0}^x g(t) dt$ është funksion uniformisht

i vazhdueshëm, rrjedh se funksioni f është i vazhdueshëm. Pjesa tjetër e vërtetimit vazhdon njëjloj si në vërtetimin e kushtit të mjaftueshëm në teoremën 2.

Teoremë 2. Kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm që funksioni f të jetë konveks në intervalin I , është që për çdo $x \in I$, ky funksion të paraqitet në trajtën

$$f(x) = C + (\mathcal{L}) \int_a^x g(t) dt, \quad (8)$$

ku g është funksion jozvogëlues në $[a,b]$ dhe C një konstante reale (në fakt, $C = f(a)$).

(Simboli (\mathcal{L}) para shenjës së integralit tregon integrim sipas Lebegut, të cilin, gjatë vërtetimit, nuk do ta shkruajmë, por do ta nënkuptojmë.)

Vërtetim

► **Të vërtetojmë që kushti (9) është i domosdoshëm.** E zëmë se f është konveks në intervalin I , Nga pohimi (P_3) rrjedh se funksioni f

është absolutisht i vazhdueshëm në çdo segment $[a,b] \subset I$. Le të jetë $x \in I$, atëherë ekziston segmenti $[a,b]$, i tillë që $x \in [a,b] \subset I$. Në bazë të teoremës së Lebegut (shih [4], faqe 345), funksioni f mund të shprehet si integral i pacaktuar (sipas Lebegut) i derivatit të tij në trajtën

$$f(x) = f(a) + \int_a^x f'(t) dt \quad (9)$$

Po të zëvendësojmë në këtë formulë derivatin $f'(t)$ me derivatin e djathtë $f'_+(t)$, formula (9) merr trajtën

$$f(x) = f(a) + \int_a^x f'_+(t) dt \quad (10)$$

ose

$$f(x) = C + \int_a^x g(t) dt \quad (11)$$

ku, sipas pohimit (P_2), funksioni $g(t) = f'_+(t)$ është funksion jozvogëlues, ndërsa $C = f(a)$.

► **Të vërtetojmë që kushti (9) është i mjaftueshëm.** E zëmë se për funksionin f është i vërtetë barazimi (9). Meqenëse integrali i

pacaktuar $(\mathcal{L}) \int_{x_0}^x g(t) dt$ është funksion absolutisht i

vazhdueshëm (shih [4], faqe 344) rrjedh se funksioni f është i vazhdueshëm. Për të vërtetuar që funksioni f është konveks, mjafton të provojmë që ai plotëson mosbarazimin (3), pra të provojmë që plotëson kushtet e lemës. Për këtë, nisemi nga ana e majtë e mosbarazimit (3):

$$f\left(\frac{x_1+x_2}{2}\right) = \frac{x_1+x_2}{2} \int_a^{\frac{x_1+x_2}{2}} g(t) dt = \frac{1}{2} \left[\left(\int_a^{x_1} g(t) dt + \int_{\frac{x_1+x_2}{2}}^{x_1} g(t) dt \right) + \left(\int_a^{x_2} g(t) dt - \int_{\frac{x_1+x_2}{2}}^{x_2} g(t) dt \right) \right]$$

$$= \frac{1}{2} \left[\begin{pmatrix} x_1 & x_2 \\ \int_a^{x_1} g(t)dt & \int_a^{x_2} g(t)dt \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} \frac{x_1+x_2}{2} & x_2 \\ x_1 & \frac{x_1+x_2}{2} \end{pmatrix} \right]$$

Meqenëse funksioni g është jozvogëlues, atëherë mund të shkruajmë:

$$\begin{pmatrix} \frac{x_1+x_2}{2} & x_2 \\ x_1 & \frac{x_1+x_2}{2} \end{pmatrix} \leq g \begin{pmatrix} x_1+x_2 & x_2-x_1 \\ \frac{x_1+x_2}{2} & \frac{x_2-x_1}{2} \end{pmatrix} = 0$$

Që këtë rrjedh se

$$f\left(\frac{x_1+x_2}{2}\right) \leq \frac{1}{2} \left(\int_a^{x_1} g(t)dt + \int_a^{x_2} g(t)dt \right) = \frac{f(x_1)+f(x_2)}{2},$$

çka provon se funksioni f është konveks në $[a,b]$.

Teoremë 3. Fiksojmë një pikë $a \in I$. Me anën e operatorëve të Rimanit ose Lebegut mund të vendoset një korrespondencë biunivoke (një për një) midis bashkësisë $\phi = \{\varphi\}$ të funksioneve jozvogëluese në një interval $I \subset \mathcal{R}$ dhe bashkësisë $F = \{f\}$ të funksioneve konvekse nga sipër në I , për të cilët $f(a) = 0$, sipas formulës

$$f(x) = \int_a^x \varphi(t)dt \quad (x \in I). \quad (12)$$

Vërtetim.

◆ Le të jetë $\varphi \in \phi$. Meqenëse φ është funksion jozvogëlues në intervalin I , atëherë ai është integrueshëm sipas Lebegut pra, edhe sipas

Rimanit. Ndërtojmë funksionin $f(x) = \int_a^x \varphi(t)dt$, ku

\int_a^x është operator integrimi i Rimanit ose i

Lebegut. Nga arsyetimet që bëjnë në teoremat 1 dhe 2 rrjedh se funksioni f është konveks në intervalin I , pra $f \in F$.

◆ Le të jetë $f \in F$. Sipas arsyetimeve në teoremat 1 dhe 2 mund të shkruajmë barazimin

$$f(x) = f(a) + \int_a^x f'_+(t)dt = \int_a^x \varphi(t)dt \quad (x \in I),$$

ku $\varphi = f'_+$ është funksion monoton jozvogëlues në I . Kështu, funksionit $f \in F$ i përgjigjet funksioni $\varphi = f'_+ \in \phi$.

◆ Le të jetë $\varphi \in \phi$. Meqenëse φ është funksion jozvogëlues në intervalin I , atëherë ai është integrueshëm sipas Lebegut pra, edhe sipas

Rimanit. Ndërtojmë funksionin $f(x) = \int_a^x \varphi(t)dt$, ku

\int_a^x është operator integrimi i Rimanit ose i

Lebegut. Nga arsyetimet që bëjnë në teoremat 1 dhe 2 rrjedh se funksioni f është konveks në intervalin I .

Vendosëm në këtë mënyrë një korrespondencë ndërmjet bashkësive. Mbetet të provojmë që kjo korrespondencë është biunivoke (një për një).

◆ Le të jenë f_1 e f_2 dy funksione të ndryshme nga ϕ , d. m. th. $f_1 \neq f_2$. Shënojmë me $\varphi_1 = f_1'$ +

e $\varphi_2 = f_2'$ +. Të vërtetojmë që $\varphi_1 \neq \varphi_2$. Në kundërt do të kishim $\varphi_1 = \varphi_2$, d. m. th.

$f_1' + = f_2' +$. Në [9] vërtetohet se në qoftë se derivati i djathtë i një funksioni të vazhdueshëm është zero në një interval, atëherë ky funksion është konstant në atë interval. Kështu, në rastin tonë, meqenëse $f_1 - f_2$ është i vazhdueshëm dhe

$(f_1 - f_2)' + = 0$ në intervalin I , rrjedh se $f_1 - f_2 = c$ (konst.) në I . Ndërkohë, meqenëse kemi $f_1(a) - f_2(a) = 0$, rrjedh se $f_1 - f_2 = 0$, d. m.

th $f_1 = f_2$, gjë që bie në kundërshtim me supozimin.

BIBLIOGRAFIA

[1] Álvarez H, (2007) On the characterization of convex functions, Rev. Unión Mat. Argent. v.48 n.1 Bahía Blanca ene. jun.
 [2] Dahl G, (2009) An Introduction to Convexity, Oslo (Norway)
 [3] Fundo M, (1984) Një vërejtje për problemin e primitivës në integrimin e Rimanit, Rev. B.SH.N, Tiranë
 [4] Kolmogorov A. N; S. V. Fomin, (1981) Elements of the Theory of Functions and

Functional Analysis (In Russian language)
"Nauka", Moscow

[5] Gjoka L, (1985) Vetë të funksioneve gjysmë të derivueshme, Rev. B.SH.N, Tiranë

[6] Sorozina É, (1999) Système D Analise, Dunod , Paris,

[7] Natanson, I. P. Theory of functions of a real variable. Vol. II. Translated from the Russian by

Leo F. Boron Frederick Ungar Publishing Co., New York 1961 265 p.

[8] Constantin P. Niculescu, Lars-Erik Persson, (2004) Convex functions and their applications- Monograf- Springer

[9] William J. Knight, (1980) Functions with zero right derivatives are constant, Monthly (657-658).

REGULAR INVERSE Γ -SEMIGROUP Γ -GJYSMËGRUPE TË RREGULLT INVERSIV.

ISLAM BRAJA^a, EDMOND PISHA^b

^a Department of Mathematics, Faculty of Natural Sciences, University "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Albania.

^b Department of Mathematics, Faculty of Natural Sciences, University of Tirana, Albania.

Email address: braja_islam@yahoo.com

AKTET IV, 3: 402 - 406, 2011

PERMBLEDHJE

Në këtë punim janë paraqitur disa rezultate e arritura në Γ -gjysmëgrupet inversiv. Në këtë artikull janë dhënë përkufizimet e Γ -gjysmëgrupit, elementit të rregullt, elementit invers, Γ -gjysmëgrupit të rregullt, duke përfshin disa argumente rreth tyre. Rezultati kryesor është teorema mbi ekuivalencën e tre kushteve të një Γ -gjysmëgrupi, ku kushti që, çdo Γ -gjysmëgrupit M është i rregullt dhe për çdo dy idempotentë të tij e dhe f kemi $eyf=fye, \gamma \in \Gamma$, është ekuivalent me kushtin që ideali kryesor i djathtë dhe çdo ideal kryesor i majtë i M ka një gjenerator idempotent unik, si edhe me kushtin që çdo element i M ka një gjenerator inversiv unik në M . Theksohet se H është një H-klasë, së cilës i takon elementi idempotent $e=exe$.

Fjalë kyçe: Γ -gjysmëgrup inversiv, element inversiv i rregullt

SUMMARY

In this paper are presented some achieved results on inversiv Γ -semigroups. In these papers are given the definitions of Γ -semigroup, regular element, invers element, regular Γ -semigroup, involving several proofs about them. The main result is the theorem on the equivalence of three conditions of a Γ -semigroup, where the condition that, any Γ -semigroup M is regular and for every two of its idempotents e and f have $eyf=fye, \gamma \in \Gamma$, is equivalent with the condition that right principal ideal and every left principal ideal of M has a unique idempotent generator, also with the condition that every element of M has a unique inverse generator in M . Emphasize that H is an H-class where the idempotent element $e=exe$ belongs to.

Key words: Inversive Γ -semigroup, Regular inversive element

1. HYRJE

Përkufizim 1.1 [8] Le të jetë $M=\{a, b, c, \dots\}$ dhe $\Gamma=\{x, y, z, \dots\}$ dy bashkësi jo boshe. M quhet Γ -gjysmëgrup në qoftë se :

1. $axb \in M$,

2. $(axb)yc=ax(byc)$ për $a, b, c \in M, x, y \in \Gamma$.

Në përkufizim i ashtuquajtur i shumëzimit, që ngjason me shumëzimin e gjysmëgrupit të zakonshëm është përkthyer në trajtë intuitive, prandaj po e saktësojmë atë.

Le të jenë $M=\{a, b, c, \dots\}$, $\Gamma=\{x, y, z, \dots\}$ dy bashkësi joboshe. Shumëzim në bashkësinë M nëpërmjet elementeve të bashkësisë Γ , të cilët janë në mes, do të quajmë çdo pasqyrim të $M \times \Gamma \times M$ në M . Këtë shumëzim do ta quajmë edhe Γ -shumëzim në M dhe e shënojmë $(\cdot)_{\Gamma}$. Rezultatit e Γ -shumëzimit në M për çdo dy elemente a, b të M dhe çdo element $x \in \Gamma$, që nuk është gjë tjetër veçse shëmbëllimi i pasqyrimin $(\cdot)_{\Gamma}$ për treshen (a, x, b) , $(\cdot)_{\Gamma}(a, x, b)$, do ta shënojmë thjesht axb .

Tani përkufizimin 1 mund t'a jepnim në një trajtë më të modernizuar:

Γ -gjysmëgrup quhet çdo çift i radhitur $(M, (\cdot)_\Gamma)$, ku M është një bashkësi joboshe, $(\cdot)_\Gamma$ është një shumëzim në M nëpërmjet elementeve të Γ për të cilin

$$\forall (a, b, c, x, y) \in M^3 \times \Gamma^2, (axb)yc = ax(byc).$$

Përkufizim 1.2. [8] Le të jetë $(M, (\cdot)_\Gamma)$ një Γ -gjysmëgrup. Në bashkësi joboshe M , bashkësi M quhet Γ -nëngjysmëgrup nëse për çdo $a \in M$ dhe $x \in \Gamma$, ekziston një element $b \in M$ i tillë që $a = (axb)_\Gamma$.

Përkufizim 1.3. [8] Në bashkësi joboshe $L(R)$ e M quhet ideal i majtë (i djathtë) në qoftë se $M \Gamma L \subseteq L$ ($R \Gamma M \subseteq R$).

Përkufizim 1.4. [8] Në bashkësi joboshe L e M quhet ideal i dyanshëm ose thjesht ideal, në qoftë se është njëkohësisht ideal i majtë dhe i djathtë.

Përkufizim 1.5. [7] Çdo ideal i djathtë (ideal i majtë, ideal i dyanshëm) i Γ -gjysmëgrupit M i cili është i ndryshëm nga M quhet i asnjellës, në qoftë se a është i rregullt i M dhe $a = (axm)_\Gamma$, atëherë elementi $b = (mya)_\Gamma$ ka vetinë:

$$b \in V_x^y(a).$$

Nga përkufizimi duket qartë se elementet a dhe b janë të rregullt.

Teoremë 2.2. Elementi a i Γ -gjysmëgrupit M është i rregullt atëherë dhe vetëm atëherë kur ekziston të paktën një $b \in V_x^y(a)$.

MATERIALI DHE METODA

Tani, në një Γ -gjysmëgrup M mund të përcaktohen relacionet analoge me relacionet e Green-it në një gjysmëgrup [4].

Le të jetë M një Γ -gjysmëgrup dhe a, b nga M . Përcaktojmë relacionet binare si më poshtë:

- (1) $a L b \Leftrightarrow (a)_l = (b)_l$.
- (2) $a R b \Leftrightarrow (a)_r = (b)_r$.
- (3) $a J b \Leftrightarrow (a) = (b)$.
- (4) $a H b \Leftrightarrow a L b \wedge a R b$
- (5) $a D b \Leftrightarrow \exists c \in M, a L c \wedge c R b$.

Shënojmë se L, R, H, J janë relacione ekuivalence në M . Klasat e ekuivalencës të elementit a të Γ -gjysmëgrupit M sipas këtyre relacioneve të ekuivalencës i shënojmë përkatësisht:

$$L_a, R_a, H_a, J_a.$$

Teoremë 1.6. (Teorema e Green-it).[1]. Në qoftë se H është një H -klasë e një Γ -gjysmëgrupi M , atëherë ose për çdo x nga Γ , $HxH \cap H = \emptyset$ ose H është një nëngrup i M_x .

Përkufizim 1.7. [4] Një element $e \in M$ quhet idempotent në një Γ -gjysmëgrup M në qoftë se ekziston një $x \in \Gamma$ i tillë që $exe = e$.

2. Γ -gjysmëgrupe të rregullt inversiv.

N. K. Saha më 1987 [6] ka dhënë këtë përkufizim:

Përkufizim. 2.1. [6] Le të jetë M një Γ -gjysmëgrup dhe $a \in M$. Le të jenë gjithashtu $b \in M$ dhe $x, y \in \Gamma$. Elementi b është një (x, y) -invers i a në qoftë se

$$a = (axb)_\Gamma \wedge b = (bya)_\Gamma.$$

Në këtë rast do të shkruajmë

Në bashkësi joboshe M , bashkësi M quhet Γ -nëngjysmëgrup nëse për çdo $a \in M$ dhe $x \in \Gamma$, ekziston një element $b \in M$ i tillë që $a = (axb)_\Gamma$.

Teoremë 2.3. Le të jetë M një Γ -gjysmëgrupit i rregullt. Le të jetë $a = (axb)_\Gamma$, atëherë kemi:

$$b = (mya)_\Gamma \text{ ka vetinë:}$$

$$(axb)_\Gamma = (ax((mya)_\Gamma x))_\Gamma = ((ax(mya)_\Gamma)_\Gamma x)_\Gamma = (((axm)_\Gamma)_\Gamma y)_\Gamma x)_\Gamma = (axm)_\Gamma = a$$

dhe

$$(bya)_\Gamma x b = (((mya)_\Gamma x)_\Gamma y)_\Gamma x b = (my((axm)_\Gamma)_\Gamma)_\Gamma x b = (mya)_\Gamma x b = (mya)_\Gamma x((mya)_\Gamma x)_\Gamma = my(ax((mya)_\Gamma x))_\Gamma = my(((axm)_\Gamma)_\Gamma y)_\Gamma x)_\Gamma = my(axm)_\Gamma = (mya)_\Gamma x m = b.$$

Këto veti tregojnë se

$$b \in V_x^y(a). \quad \blacksquare$$

Teoremë 2.3. Le të jetë M një Γ -gjysmëgrupit i rregullt. Le të jetë $a = (axb)_\Gamma$,

$$b \in M \text{ dhe } x, y \in \Gamma \text{ të tillë që } b \in V_x^y(a),$$

atëherë kemi:

- (1) axb dhe bya janë idempotentë;
- (2) $a D b$.

Vërtetim. (1) Mund të shkruajmë:

$$(axb)y(axb) = ((axb)_\Gamma y)_\Gamma x b = axb,$$

pra, axb është idempotent.

Po kështu, tregohet se $(bya)x(bya) = bya$.

(2) Meqenë qoftë se axb është idempotent, për idealin e djathtë kryesor të përfutur nga axb , kemi:

$$(axb)_\Gamma = axb \cup (axb)\Gamma M = (axb)\Gamma M.$$

Gjithashtu, meqenë qoftë se $a = (axb)_\Gamma$, gjejmë se $(a)_\Gamma = a\Gamma M$. Tani është e qartë se $(axb)\Gamma M = a\Gamma M$, që tregon se $a R axb$.

Njëlloj tregohet se $axb L b$. Duke ditur

$$D = R \circ L = L \circ R$$

arrijmë në përfundimin se $a D b$.

Teoremë 2.4.[6]Le të jetë M një Γ -gjysmëgrupit i rregullt dhe $a \in M$. Supozojmë se $e = exe$ dhe $f = yfy$, për $x, y \in \Gamma$ janë dy idempotentë të tillë që

e R a L f, atëherë ekziston një $b \in V_x^y(a)$, i vetëm i tillë që $ayb=e$ dhe $bxa=f$.

Teoremë 2.5. Le të jetë M një Γ -gjysmëgrupit i rregullt dhe $a=(axb)ya$ një element i tij. Atëherë H^x dhe H^y janë Γ -nëngrupe të M.

Vërtetim. Nga teorema 2.3. elementet $a=axb$ dhe $f=bya$ janë përkatësisht y dhe x,y-idempotentë. Le të jetë H, H-klasa në të cilën bën pjesë idempotenti $e=eye$. Nga ku del se H-klasa H është Γ -nëngrup H^y .

Po kështu, po të jetë H, H-klasa që përmban idempotentin $f=bya$, atëherë H^x është Γ -gjysmëgrup.

Teoremë 2.6.[6] Le të jetë M një Γ -gjysmëgrupit dhe $a \in M$. Shënojmë me D_a , D-klasën e M që përmban a. Në qoftë se a është i rregullt, atëherë çdo element i D_a është i rregullt.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Tani do të përcaktojmë një klasë të rëndësishme dhe speciale të Γ -gjysmëgrupeve të rregullt.

Dy elemente a dhe b të një Γ -gjysmëgrupi M janë përftues inversë të njeri-tjetrit në qoftë se

$$a=(axb)ya \wedge b=(bya)xb,$$

ku $x, y \in \Gamma$.

Pra, b është një (x, y)-invers i a, kurse a është një (y, x)-invers i b.

Teorema 2.2 tregon se elementi a i Γ -gjysmëgrupit M është i rregullt atëherë dhe vetëm atëherë kur ekziston të paktën një $b \in V_x^y(a)$. Gjatë vërtetimit, në qoftë se $a=(axm)ya$, po të merret $b=(mya)xm$ gjejmë

$$a=(axb)ya \wedge b=(bya)xb.$$

Pra, elementet a dhe b janë përftues inverse të njeri-tjetrit.

Teoremë 2.7. Konditat e mëposhtme në një Γ -gjysmëgrup M janë ekuivalente:

(1) M është i rregullt dhe për çdo dy idempotentë $e=exe$ dhe $f=xfx$, $x, y \in \Gamma$ kemi që $f=xfx$, $e\gamma f=f\gamma e$, $\forall \gamma \in \Gamma$.

(2) Çdo ideal kryesor i djathtë dhe çdo ideal kryesor i majtë i M ka përftues idempotent të vetëm.

(3) Çdo element i M ka një përftues invers të vetëm në M.

Vërtetim. (1) \Rightarrow (2) Duke ditur se çdo ideal kryesor i djathtë i M ka të paktën një përftues idempotent, pra, për $a \in M$, ekziston $e=exe$, $x \in \Gamma$, i tillë që $(a)_r=exM$. Supozojmë se f është një idempotent, $f=fyf$, i tillë që $exM=fyM$. Tani gjejmë se $e=fym$ dhe $f=exn$, për $m, n \in M$. Mund të shkruajmë:

$$fxe=fx(fym)=(fxf)ym=fym=e$$

dhe

$$exf=ex(exn)=(exe)xn=exn=f.$$

Atëherë gjejmë

$$e=fxe=exf=f.$$

(2) \Rightarrow (3) Nga vërtetësia e (2) dhe teorema 2.4 del se çdo element i M është i rregullt. Teorema 2.2 tregon se çdo element $a \in M$ ka të paktën një përftues invers b. Në qoftë se c është një përftues invers tjetër i a, kemi:

$$a=(axb)ya, \quad b=(bya)xb, \quad x, y \in \Gamma,$$

$$a=(azc)ta, \quad c=(cta)zc, \quad z, t \in \Gamma.$$

Është e qartë se $e=axb$ dhe $f=azc$ janë idempotentë, $e=eye$ dhe $f=ftf$. Gjithashtu edhe $e'=bya$ dhe $f'=cta$ janë idempotentë, $e'=e'xe'$ dhe $f'=f'zf'$.

Meqenë qoftë se elementi a është i rregullt, kemi:

$$(a)_r=eyM=ftM,$$

$$(a)_l=Mye'=Mzf'.$$

Kështu, nga kondita (2) kemi:

$$e=axb=azc=f,$$

$$e'=bya=cta=f'.$$

Nga këto barazime gjejmë:

$$b=(bya)xb=by(axb)=by(azc)=(bya)zc=(cta)zc=c.$$

(3) \Rightarrow (1) Meqenë qoftë se çdo element i M ka përftues të vetëm, nga teorema 2.2, M është i rregullt. Kështu që do të tregojmë se plotëson konditat e pjesës së dytë të pikës (1). Pra, kemi që nga pohimi (3) rrjedh pohimi (1)

Nga teorema 2.2, çdo element i M është i rregullt. Kështu, le të jenë $e=exe$, $f=fyf$, $x, y \in \Gamma$, dy idempotentë të M. Së pari, do të vërtetojmë se $e\gamma f$, $\gamma \in \Gamma$, është përsëri idempotent. Le të jetë a përftuesi invers i $e\gamma f$,

$$((e\gamma f)x_1a)x_2(e\gamma f)=e\gamma f,$$

$$(ax_2(e\gamma f))x_1a=a,$$

ku $x_1, x_2 \in \Gamma$.

Marrim $b=ax_2e$. Gjejmë se:

$$\begin{aligned}
& ((e\gamma f)x_1(ax_2e))x(e\gamma f) = (e\gamma f)x_1((ax_2e)x(e\gamma f)) = \\
& (e\gamma f)x_1(ax_2(ex(e\gamma f))) \\
& = \\
& (e\gamma f)x_1(ax_2((exe)\gamma f)) = (e\gamma f)x_1(ax_2(e\gamma f)) \\
& ((e\gamma f)x_1a)x_2(e\gamma f) = (e\gamma f), \\
& ((ax_2e)x(e\gamma f))x_1(ax_2e) = (ax_2(ex(e\gamma f)))x_1(ax_2e) \\
& = (ax_2(e\gamma f))x_1(ax_2e) = ((ax_2(e\gamma f))x_1 \\
& a)x_2e = ax_2e.
\end{aligned}$$

Këto barazime dhe kushti (3) sjellin se $b = ax_2e = a$.

Po të shënojmë $c = fx_1a$, përsëri gjejmë:

$$\begin{aligned}
& ((e\gamma f)\gamma(fx_1a))x_2(e\gamma f) = e\gamma f, \\
& ((fx_1a)x_2(e\gamma f))\gamma(fx_1a) = fx_1a.
\end{aligned}$$

Përsëri këto barazime dhe kondita (3) sjellin se $c = fx_1a = a$. Kështu, do të kemi:

$$\begin{aligned}
& a\gamma a = (ax_2e)\gamma(fx_1a) = ax_2(e\gamma(fx_1a \\
&)) = ax_2((e\gamma f)x_1a) = \\
& = (ax_2(e\gamma f))x_1a = a.
\end{aligned}$$

Meqenë qoftë se një element idempotent është përfutës invers i vetes, përsëri nga kondita (3) marrim $a = e\gamma f$, prej nga $e\gamma f$ është një idempotent i M . Gjithashtu, arrijmë në përfundimin se për çdo idempotent $e = exe$, $x \in \Gamma$, kemi që $e\gamma e = e$ për çdo $\gamma \in \Gamma$.

Tani le të jenë e dhe f dy γ -idempotentë për çdo $\gamma \in \Gamma$. Meqenë qoftë se e , f , $e\gamma f$ dhe $f\gamma e$ janë γ -idempotentë, kemi:

$$((e\gamma f)\gamma(f\gamma e))\gamma(e\gamma f) = (e\gamma(f\gamma(f\gamma e)))\gamma(e\gamma f) = (e\gamma((f\gamma f)\gamma e))\gamma(e\gamma f) =$$

=

$$(e\gamma(f\gamma e))\gamma(e\gamma f) = e\gamma((f\gamma e)\gamma(e\gamma f)) = (e\gamma f)\gamma(e\gamma f) = e\gamma f.$$

Njëlloj tregohet se

$$((f\gamma e)\gamma(e\gamma f))\gamma(f\gamma e) = f\gamma e.$$

Pra, $e\gamma f$ dhe $f\gamma e$ janë inversë të njeri-tjetrit. Përsëri nga kondita (3) arrijmë në përfundimin se $e\gamma f = f\gamma e$.

Me Γ -gjysmëgrup inversiv kuptojmë Γ -gjysmëgrupin M që ka vetitë ekuivalente (1), (2) dhe (3).

Përkufizim 2.8. Elementi a i Γ -gjysmëgrupit M quhet plotësisht i rregullt në qoftë se ekziston $x \in \Gamma$, $b \in M$ të tillë që $a = (axb)xa$ dhe $axb = bxa$. Γ -

gjysmëgrupi M quhet plotësisht i rregullt në qoftë se çdo element i tij është plotësisht i rregullt.

Teoremë 2.9. Në qoftë se elementi $a = (axb)xa$, $x \in \Gamma$, $b \in M$, është plotësisht i rregullt, atëherë ekziston elementi $c \in V_x^x(a)$ i tillë që

$$axc = cxa.$$

Vërtetim. Shënojmë me $c = (bxa)xb$. Kemi:

$$\begin{aligned}
& (axc)xa = (ax((bxa)xb))xa = ((ax(bxa))xb)xa = \\
& (axb)xa = a,
\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
& (cxa)xc = (((bxa)xb))xc = ((bx(axb)xa)xc) = (bx((axb)xa)) \\
& xc = (bxa)xc =
\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
& = (bxa)x((bxa)xb) = bx(ax((bxa)xb)) \\
& = bx((ax(bxa))xb) = bx(axb) = \\
& = (bxa)xb = c.
\end{aligned}$$

Gjithashtu gjejmë:

$$\begin{aligned}
& axc = ax((bxa)xb) = (ax(bxa))xb = axb = bxa = \\
& = bx((axb)xa) = (bx(axb))xa = cxa.
\end{aligned}$$

Teoremë 2.10. Një Γ -gjysmëgrup M është plotësisht i rregullt atëherë dhe vetëm atëherë kur çdo kuazi-ideal i M është Γ -nëngjysmëgrup plotësisht i rregullt.

Vërtetim. Le të jetë Q një kuazi-ideal i Γ -gjysmëgrupit plotësisht të rregullt M dhe $a \in Q$. Nga teorema 2.9 ekziston elementin $c \in V_x^x(a)$ i tillë që $axc = cxa$, pra

$$a = (axc)xa \text{ dhe } c = (cxa)xc.$$

Prej këtej $(a)_q = (c)_q$. Pra, $c \in (a)_q \subset Q$ dhe si rrjedhim Q është plotësisht i rregullt.

E anasjella është e qartë.

Në klasën e Γ -gjysmëgrupeve të rregullta nënklasa e Γ -gjysmëgrupeve plotësisht të rregullta mund të karakterizohet me anën e kuazi-idealeve. Problemet që lidhen me kuazi-idealet janë studiuar në artikujt [1], [2], [3]. Karakterizimin për këtë nënklasë mund ta realizojmë me:

Teoremë 2.11. Një Γ -gjysmëgrup M është plotësisht i rregullt atëherë dhe vetëm atëherë kur për çdo $a \in M$ ekziston një element invers b i a i tillë që $(a)_q = (b)_q$.

Vërtetim. Le të jetë M një Γ -gjysmëgrup plotësisht i rregullt dhe $a \in M$. Nga teorema 2.9.

ekziston $c \in V_x^x(a)$ i tillë që $axc=cxa$. Ashtu si te teorema e mësipërme tregohet $(a)_q=(b)_q$.

Anasjellas, le të jetë a një element i Γ -gjysmëgrupit të rregullt M për të cilin ekziston $b \in V_x^x(a)$ i tillë që $(a)_q=(b)_q$. Meqenë qoftë se

$$a=(axb)_a, b=(bxa)_b=by(axb),$$

atëherë kemi:

$$(a)_r \subset (axb)_r, (b)_l \subset (axb)_l.$$

Përfshirjet:

$$(axb)_r \subset (a)_r, (axb)_l \subset (b)_l$$

janë fare të qarta.

Nga përfshirjet e mësipërme, përfitojmë barazimet:

$$(a)_r=(axb)_r, (b)_l=(axb)_l.$$

Nga barazimi $(a)_q=(a)_r \cap (a)_l=(b)_r \cap (b)_l=(b)_q$ gjejmë

$$(a)_l=(b)_l, (a)_r=(b)_r.$$

Tani, si përfundim, kemi

$$(a)_r=(b)_r, (a)_l=(b)_l.$$

Pra,

$$(a)_q=(b)_q=(axb)_q.$$

Nga teorema 1.6, meqenë qoftë se a, b dhe axb i përkasin të njëjtës H -klasë H_a të përfshirur të kuazi-idealit kryesor $(a)_q$, atëherë H_a është H^x grup. Shënojmë me e njëshin e grupit H^x . Atëherë kemi $axb=bx a=e$. Ndërkohë kemi:

$$a=axe=ax(bxa)=(axb)xa,$$

$$b=bx e=bx(axb)=(bxa)xb.$$

Pra, $b \in V_x^x(a)$. Kështu Γ -gjysmëgrupi M është plotësisht i rregullt.

BIBLIOGRAFIA

1. Braja I (2008) Equivalences in regular Γ -semigroups, The scientific bulletin UNIEL Proceeding, 3, 85-90.
2. Braja I (2007) Kuazi-idealet minimal dhe bi-idealet në Γ -gjysmëgrupet. Buletini shkencor UNIEL, 3, 29-35.
3. Braja I (2008) Karakterizime të disa klasave të Γ -gjysmëgrupeve me anë të idealeve", Buletini shkencor UNIEL, 4, 13-21.
4. Dutta TK, Chatterjee TK (1987) Green's equivalences on Γ -semigroup". Bull. Col. Soc. 80, 30-35.
5. Petro P, Xhillari Th (2008) Teorema e Green-it dhe kuazi-idealet minimale, Konferenca Ndërkombëtare e Algjebrës dhe Analizës Funktionale, Buletini shkencor UNIEL, Proceedings, 3.
6. Saha NK (1987) On Γ -semigroup-II, Bull. Col. Math. Soc. 79, 331-335.
7. Saha NK (1988) On Γ -semigroup-III, Bull. Col. Math. Soc. 80, 1-12.
8. Sen MK, Saha NK (1988) On Γ -semigroup, I. Bull. Col. Math. Soc. 80, Saha NK, 180-187.

POSSIBILITIES FOR IMPROVING THE CUTTING EFFICIENCY IN BAND SAWS MBI MUNDËSITË E PËRMIRËSIMIT TË KOEFICIENTIT TË PËRDORIMIT TË SHARRAVE SHIRIT PËR PRERJEN E TRUPAVE

ARBEN BEJTJA, FIRDUS HAVERAJ, PANDELI MARKU

Departamenti i Industrisë së Drurit, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kodër
Kamëz, Tiranë, SHQIPËRI
Email: arbenbejtja@yahoo.fr

AKTET IV, 3: 407 - 411, 2011

PERMBLEDHJE

Sot në Shqipëri sharrimi i trupave realizohet pothuajse tërësisht me makina sharra shirit. Kjo i dedikohet përparësive që këto makina kanë në krahasim me gaterat. Ndryshimi qëndron se në makinën gatër kemi prerje njëherëshe të trupit nga shumë lama, ndërsa në sharrën shirit trupi pritët në dërrasa një nga një. Ky ndryshim bën që kjo makinë të ketë koeficiente shfrytëzimi mjaft të ulët, por që kompensohet me përparësi të tjera. Gjetja e mundësive për përmirësimin e këtyre koeficienteve merr përparësi të veçantë. Studimi u realizua në dy ndërmarrje të ndodhura në zonën e Librazhdit dhe të Pukës. Në studim u gjendën dhe u analizuan disa faktorë ndikues në përmirësimin e këtyre koeficienteve të zbatueshëm nga të gjitha firmat e sharrimit të trupave. Për këtë u matën, u llogaritën dhe u analizuan dy koeficiente: koeficienti i shfrytëzimit të kohës së punës dhe koeficienti i përdorimit të makinës për prerje efektive. Rezultatet e studimit tregojnë se ekzistojnë mundësi të rritjes me dy shifra të rendimentit sasior.

Fjalë çelës: Sharrë shirit, gatër, trup sharre.

SUMMARY

Currently in Albania the sawing of logs is carried out mainly by using band saw machines. This is due to several advantages provided by those machines compared to frame saw machines. The difference between them is that frame saw realizes the logs cutting simultaneously, while the band saw offers one by one logs cutting. This change makes this machine to have very low utilization rate, but that is compensated by other advantages. Finding the opportunities to improve the cutting efficiency takes a particular importance. The study was carried out in two saw mill enterprises located in Librazhd and Puka. In the represented study are found and analyzed some factors that provide impact in the improvement of utility coefficients. For this aim are measured, calculated and analyzed two coefficients; utility coefficient of working time and utility coefficient for effective cutting. The results indicate that there exists opportunity to increase by two digits the quantity performance.

Key words: Band saw, frame saw, logs.

HYRJE

Industria e përpunimit të drurit në Shqipëri përbëhet nga ndërmarrje të prodhimit të lëndës së parë (prodhimi i lëndës së sharruar dhe nënprodukteve të saj) dhe ndërmarrje të përpunimit të këtyre materialeve dhe të tjera me bazë druri.

Firmat e përpunimit të lëndës së parë trupa ndodhen pothuaj në të gjithë territorin e vendit dhe më të përhapura janë në zonat e Shqipërisë Lindore, të Mesme dhe të Veriut. Sharrimi i trupave sot është i ndryshëm nga ai i para viteve '90. Nga sharrimi kryesisht me gatra, sot prodhimi i lëndës së sharruar realizohet pothuaj me sharra shirit të llojeve dhe modeleve të

ndryshme, duke filluar nga ato të thjeshtat deri në të mekanizuara.

Procesi i sharrimit me sharra shirit është një metodë e avancuar e sharrimit të drurit. Kjo i dedikohet një sërë anësh pozitive që kanë këto makina në krahasim me gatrat ku përmendim [1], [2]:

- Metoda e prerjes së trupave lejon të zgjidhet cilësia e dërrasave që do të prodhohen.

- Mënjanohet domosdoshmëria e operacioneve të ndarjes së trupave në grupe diametrash.

- Trashësia e vogël e shiritit dhe pakësimi i madhësisë së çaprazit ul në minimum humbjet e drurit në tallash që del gjatë sharrimit të trupave etj.

- Shiriti i hollë, sipas kushteve të prerjes së ashklës mund të sigurojë shpejtësi prerjeje rekord që arrin dhe mbi 40 m/s.[3]

Në të gjithë vendin ndodhen rreth 200 firma të kapaciteteve të ndryshme.

MATERIALET DHE METODA

Parimi bazë i procesit të sharrimit në gatra realizohet nëpërmjet prerjes njëherësh të trupit në shumë lama (duke nxjerrë disa dërrasa), ndërsa në sharra shirit ky proces realizohet duke bërë prerjen një nga një të dërrasave.

Prodhimtaria e sharrës shirit për prerje trupash llogaritet me formulën [4]:

$$P = \frac{T \cdot K_1 \cdot K_2 \cdot q}{t} \quad [m^3/\text{ndërrësë}]$$

ku:

T - koha e punës e ndërrësës [min],

K_1 - koeficienti i përdorimit të kohës së punës,

K_2 - koeficienti i përdorimit të makinës,

q - vëllimi mesatar i trupit [m^3].

t – koha e nevojshme për sharrimin e një trupi [min]

Një metodë tjetër e llogaritjes së prodhimitarisë së makinës sharrë shirit për prerjen e trupave bazohet në formulën e mëposhtme [1]:

$$P = \frac{377 \cdot A \cdot K_1 \cdot K_2 \cdot d^2}{Z} \quad [m^3/\text{ndërrësë}]$$

ku:

A – shpejtësia e avancit të vagonetës [m/min],

K_1 – koeficienti i përdorimit të kohës së punës,

K_2 – koeficienti i përdorimit të makinës,

d – diametri mesatar i trupave [m],

z – numri mesatar i prerjeve që bëhen në trup.

Siç shihet në formulat e llogaritjes së prodhimitarisë së sharrës shirit, për të pasur rendimente të kënaqshme, një rëndësi të veçantë marrin: koeficienti K_1 i quajtur koeficienti i përdorimit të kohës së punës dhe koeficienti K_2 i përdorimit të makinës për prerje efektive.

Në koeficientin K_1 përfshihen të gjitha ndalesat apo veprimet që bëhen me makinë të ndaluar. Këtu mund të përfshihen veprimet për ndërrimin e shiritit, për kontrollin e përmasës së dërrasës së parë, për riparim, për ndërprerje teknike, ndërprerje për nevoja të punëtorit, pastrim të vendit të punës etj. Mund të themi që koeficienti K_1 ka të bëjë me organizimin e punës.

Në koeficientin K_2 parashikohen humbjet e fshehta (të padukshme) të makinës në punë. Këtu përfshihen kohët për ngarkimin e trupit në vagonetë, koha e centrimit të trupit, koha për kthimin prapa të vagonetës, koha e zhvendosjes tërthore të trupit në përshtatje me trashësinë e lëndës së sharruar që do të prodhohet etj. Pra, ky koeficient merr parasysh kohën që sharra është në lëvizje, por nuk sharron. Në këtë koeficient ndikon shkalla e mekanizimit të makinës.

Koeficienti i shfrytëzimit të sharrës shirit për trupa llogaritet:

$$K = K_1 \cdot K_2$$

Matjet e koeficienteve K_1 dhe K_2 u kryen në firmën *Sanida Sh.p.k.* Pprenjas dhe në firmën *Gjini Sh.p.k.* Fushë-Arrëz. Çdo matje është realizuar për një periudhë kohe $T = 240$ min. Gjatë matjeve kemi përcaktuar:

- kohën e punës së sharrës t_1 ,

- kohën t_2 të harxhuar për ndalesat e dukshme gjatë kohës T ,

- kohën e dobishme të sharrës shirit t_3 ,

- kohën e harxhuar për humbjet e fshehta t_4 .

Kohët dhe koeficientët janë llogaritur si më poshtë:

- Koha e përgjithshme për kryerjen e çdo prove është [1]:

$$T = t_1 + t_2$$

- Koha e punës e sharrës shirit është:

$$t_1 = t_3 + t_4$$

ose:

$$T = t_2 + t_3 + t_4$$

- Koeficienti i shfrytëzimit të kohës së punës së sharrës shirit llogaritet me formulën:

$$K_1 = \frac{t_1}{T} = \frac{t_1}{t_1 + t_2}$$

- Koeficienti i shfrytëzimit të kohës të makinës sharrë shirit llogaritet me formulën:

$$K_2 = \frac{t_3}{t_1} = \frac{t_3}{t_3 + t_4}$$

Kurse koeficienti i shfrytëzimit të sharrës shirit për trupa llogaritet me formulën [1]:

$$K = K_1 \quad K_2 = \frac{t_1}{T} \cdot \frac{t_3}{t_1} = \frac{t_3}{T}$$

Duke pasur parasysh që në koeficientin K_2 ndikojnë dhe përmasat e trupit; për kryerjen e provave, në të dy firmat u përdoren trupa ahu me diametër mesatar 28-35 cm dhe gjatësi 3 m. Forma e trupave u zgjodh brenda standardit. Gjithashtu nga pasaportat e makinave u veçuan dhe dhëna teknike dalluese për të dy makinat të paraqitura në tabelën 1.

Emërtimi i firmës	Tipi i sharrës shirit për trupa	Diametri i volantit mm	Mënyra e furnizimit	Mënyra e centrimt	Të dhëna të tjera
Sanida Sh.p.k	Primultini	130	Transportier me zinxhir	E mekanizuar	Të ngjashme
Gjini Sh.p.k	Artiglio	130	Me plan të pjerrët, shina	Me dorë	Të ngjashme

Tabela 1. Të dhëna teknike kryesore që dallojnë sharrat shirit të dy firmave

Matjet te Sanida sh.p.k	Kohët në minuta					Koeficientët		
	T	t ₁	t ₂	t ₃	t ₄	K ₁	K ₂	K
I	240	180	60	69	111	0,75	0,38	0,29
II	240	186	54	70	116	0,77	0,38	0,29
III	240	173	67	62	111	0,72	0,36	0,26
IV	240	196	44	71	125	0,82	0,36	0,30
V	240	184	56	63	121	0,76	0,36	0,28
Mesatarja	240	184	56	67	117	0,77	0,36	0,28

Tabela 2. Kohët e matura dhe koeficientët përkatës në firmën SANIDA Sh.p.k

Matjet te Gjini sh.p.k	Kohët në minuta					Koeficientët		
	T	t ₁	t ₂	t ₃	t ₄	K ₁	K ₂	K
I	240	193	47	55	138	0,80	0,28	0,21
II	240	200	40	56	144	0,83	0,28	0,23
III	240	198	42	63	134	0,82	0,32	0,26
IV	240	192	48	61	131	0,80	0,32	0,26
V	240	197	43	60	137	0,82	0,30	0,25
Mesatarja	240	196	44	59	137	0,81	0,30	0,24

Tabela 3. Kohët e matura dhe koeficientët përkatës në firmën GJINI Sh.p.k

Si dallime kryesore në organizimin e punës u përcaktuan:

- Për ndërrimin e sharrës në firmën *Sanida* Sh.p.k., operatori kryesor shkon dhe merr sharrën

në repartin e mprehjes, e vendos në makinë dhe i jep vetë çapraz.

- Në firmën *Gjini* Sh.p.k. çaprazi jepet në repartin e mprehjes nga lamamprehësi, i cili dhe e çon sharrën pranë makinerisë.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet e matjeve të kryera në firmën *Sanida* Sh.p.k dhe *Gjini* Sh.p.k dhe llogaritjet e koeficientëve jepen në tabelat 2 dhe 3.


Rezultatet e matjeve të kryera në firmën *Sanida* Sh.p.k, *Gjini* Sh.p.k dhe llogaritjet e koeficientëve jepen në tabelat 2 dhe 3.

Nga të dhënat e tabelave rezulton se koeficienti i shfrytëzimit të sharrës shirit në firmën ***Sanida* Sh.p.k** është **$K = 0,28$** dhe në firmën ***Gjini* Sh.p.k** **$K = 0,24$**


Vlerat e tri kohëve t_1 , t_2 dhe t_3 për të dy firmat janë paraqitur në grafikët 1 dhe 2.

Shpërndarja e kohës së punës t_1 dhe e kohës për ndalesa të dukshme t_2 jepen në grafikët 3 dhe 4.


Vlerat e koeficientëve të shfrytëzimit të kohës së punës K_1 , K_2 dhe K për të dyja firmat jepen në grafikët 5 dhe 6.




Grafiku 1. Shpërndarja e kohës t_1 me përbërëset e saj t_3 dhe t_4 në firmën SANIDA Sh.p.k.




Grafiku 2. Shpërndarja e kohës t_1 me përbërëset e saj t_3 dhe t_4 në firmën GJINI Sh.p.k.




Grafiku 3. Shpërndarja e kohëve të punës t_1 dhe për ndalesa të dukshme t_2 në firmën SANIDA Sh.p.k.



Grafiku 4. Shpërndarja e kohëve të punës t_1 dhe për ndalesa të dukshme t_2 në firmën GJINI Sh.p.k.



Grafiku 5. Koeficientët e shfrytëzimit të kohës së punës K_1 , K_2 dhe K në firmën SANIDA Sh.p.k.



Grafiku 6. Koeficientët e shfrytëzimit të kohës së punës K_1 , K_2 dhe K në firmën GJINI Sh.p.k.

PËRFUNDIME

Duke analizuar studimin e kryer nxjerrim këto përfundime:

- Sharrat shirit për prerjen e trupave kanë koeficientin e shfrytëzimit të makinës më të ulët, krahasuar me makinat e tjera të përpunimit mekanik të drurit. Kjo vjen nga konstruksioni i tyre dhe nga teknologjia e prodhimit. [4].

- Nga të dhënat në tabela dhe nga grafikët bie në sy që megjithëse te firma *Sanida* sh.p.k linja e sharrimit është më e mekanizuar, koha e punës t_1 e makinës dhe për pasojë koeficienti K_1 është më e ulët se te *Gjini* sh.p.k ($K_1 = 0,77$ te *Sanida* sh.p.k. dhe $K_1 = 0,81$ te *Gjini* sh.p.k.). Kjo vjen për arsye të botëkuptimit që kanë drejtuesit dhe punëtorët në firmë që "çaprazi duhet të jepet nga makinisti pas vendosjes së sharrës në makinë dhe jo në repart nga lamaprehësi". Kjo me justifikimin e përgjegjësisë për cilësinë e sharrimit.

Te firma *Gjini* sh.p.k ky koncept nuk ekziston, gjë që bën që koha e punës së makinës të jetë më e lartë dhe që në një farë mënyre "kompenson" shkallën e ulët të mekanizimit të saj. Vetëm nga ky fakt firma *Sanida* sh.p.k. ka një ulje të prodhimtarisë 15-17 %.

- Në prodhimtarinë e sharrës shirit për trupa dhe në koeficientin e shfrytëzimit të makinës ndikon shumë koeficienti i shfrytëzimit të kohës së makinës K_2 që varet nga koha për prerje efektive t_3 dhe nga koha t_4 që varet nga humbjet në kohë me makinë në punë. Nga studimi i kryer bie në sy rëndësia e shkallës së mekanizimit, e cila për

rastet e marra në studim kompenson me shumicë të metat e organizimit (koeficienti $K_2 = 0,36$ për *Sanida* sh.p.k dhe $K_2 = 0,30$ për *Gjini* sh.p.k) dhe siguron një prodhimtari më të madhe. Furnizimi me trupa i makinës sharrë shirit te firma *Sanida* sh.p.k bëhet me ndihmën e transportuesit tërthor me zinxhirë, ndërsa te firma *Gjini* sh.p.k.bëhet me krahë. Përveç kësaj, te firma *Sanida* sh.p.k. rrotullimi dhe centrimi i trupit në karrel është i mekanizuar, ndërsa te firma *Gjini* sh.p.k. bëhet me dorë. Për kushte të njëjta të organizimit, diferenca në prodhimtari midis dy firmave do duhej të ishte mbi 22%.

REKOMANDIME

- Firmat e prodhimit të lëndës së sharruar kanë mundësi të bëjnë përmirësime të dukshme në organizimin e punës, duke ulur në minimum operacionet me makinë të ndaluar. Për në studim, disa operacione si heqja dhe vendosja e sharrave, pastrimet apo ndonjë operacion tjetër mund të bëhen jashtë kohës T të makinës.

- Investimet e reja apo rikonstruksionet duhet të bëhen të studiuara dhe makineritë që mendohet të blihen, duhet t'i nënshtrohen një analize të plotë tekniko-ekonomike.

- Asistenca e inxhinierëve me eksperiencë në këtë fushë për problemet e mësipërme do të ishte me efekte pozitive të qëndrueshme dhe afatgjatë.

LITERATURA

- [1] Fico S., Marku P., Shqau I. *Prodhimi i lëndës drusore të sharruar*. Pegi, Tiranë 1998.
- [2] Giordano G. *Tecnologia del legno 2**. Unione Tipografico-Editrice Torinese, Torino 1983.
- [3] Mokovskovo N.H. *Teorija i konstrukci djerevo obrabativajushih mashin*. Lesnaja promishlenost, Moskva 1990.
- [4] Dimoshi S. *Makinat dhe instrumentat prerës të drurit*. MIRGEERLALB, Tiranë 2008..

ISSUES OF WOOD PROCESSING INDUSTRY IN ALBANIA PROBLEMATIKA TË INDUSTRIË SË PËRPUNIMIT TË DRURIT NË SHQIPËRI

ARBEN BEJTJA^{1*}, ARBEN BOÇARI², ALKETA GREPCKA¹

¹Departamenti i Industrisë së Drurit, Fakulteti i Shkencave Pyjore

²Departamenti i Matematikës dhe i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Bujqësor, Kodër Kamëz, Tiranë, SHQIPËRI

Email: arbenbejtja@yahoo.fr

AKTET IV, 3: 412 - 417, 2011

PERMBLEDHJE

Industria e përpunimit të drurit në Shqipëri e përbërë nga shumë firma të biznesit të madh dhe nga qindra punishte të vogla të shpërndara në të gjithë vendin përballet çdo ditë me probleme të ndryshme teknike dhe organizative. Qëllimi kryesor i studimit është evidentimi i problemeve kryesore të firmave të mëdha. Realizimi i studimit është kryer nëpërmjet një pyetësoi të detajuar të përgatitur nga pedagogë të fushës së industrisë së përpunimit të drurit, ekonomist, matematikanë. Pyetësoi përmbledh rreth 28 rubrika me afër 240 të dhëna. Studimi është realizuar në periudhën 2006-2010. Aktualisht është mbledhur informacion për 49 biznese të mëdha. Të dhënat e pyetësorëve janë hedhur në një bazë të dhënash (*database*), prej ku janë nxjerrë të dhëna mbi problemet më kryesore që shqetësojnë industrinë e përpunimit të drurit në Shqipëri dhe shërbejnë për përmirësime të mëtejshme. Pjesë të rëndësishme të tyre jepen në materialin e prezantuar.

Fjalë çelës: industria e përpunimit të drurit, pyetësor, probleme teknike-teknologjike.

SUMMARY

Wood processing industry in Albania composed by several big enterprises and hundred small companies expanded in entire territory of the country is facing every day different technical and organizational issues. The main purpose of the study is to identify the crucial issues of big enterprises. The implementation of the study is carried out through detailed questionnaire prepared by the lecturers in field of wood-processing, economic and mathematic. The questionnaire includes 28 rubrics with an approximately expectation of gathering 280 data. The study has carried out during of period 2006-2010. Actually is gathered information over 49 big enterprises. The raw data are loaded in a database and are processed in order to distinguish the most crucial issues in this industry. The data over the most problematic sectors describes the general situation of the wood processing industry in Albania and serves for further improvement. Some important recommendations are included in this paper-research.

Key words: wood processing industry, questionnaire, technical-technological issues.

HYRJE

Mbas viteve '90 Industria e Përpunimit të Drurit në Shqipëri pësoi ndryshime të mëdha [1], të cilat u shfaqën në shumë aspekte [2]. Nga një ekonomi shtetërore e centralizuar e organizuar në fabrika e kombinate u kalua në biznese të vogla dhe të mesme ku shumicën e zënë bizneset e vogla në nivel punishtesh [3] dhe më vonë vinë repartet dhe fabrikat [4]. Nga një ekonomi

shtetërore e planifikuar u kalua në një ekonomi të tregut të lirë me pronarë me kualifikime dhe eksperiencë nga më të ndryshmet.

Industria e përpunimit të drurit në Shqipëri, ashtu si dhe industritë e tjera [5], përballet me një sërë problemesh që varen nga faktorë të ndryshëm. Këta faktorë ndikojnë në mënyra të ndryshme në treguesit e përgjithshëm dhe të veçantë tekniko-ekonomik të firmave.

Në përgjithësi mungon një informacion mbi gjendjen dhe ecurinë e tyre. Për këtë arsye nga Departamenti i Industrisë së Drurit pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore është ndërmarrë studimi me temë “Problematika të industrisë së përpunimit të drurit në Shqipëri”. Qëllimi i tij nuk është vetëm të konstatojë gjendjen e firmave prodhuese të industrisë së drurit, por të ngrejë dhe problematikat që lidhen me përmirësime të mundshme. Të dhënat e studimit mund të vetanalizohen nga subjektet e industrisë së drurit. Ato mund të identifikojnë mungesat në proceset e tyre dhe njëkohësisht të bëjnë krahasim me subjektet e tjera. Një qëllim afatmesëm i studimit është të ndjekë ecurinë e firmave duke parë ndryshimet e tyre në kohë të lidhura me qëllimet perspektive të shprehura dhe trendet e ekonomisë shqiptare.

MATERIALI DHE METODA

Fillimisht të dhënat u morën nga Vjetari Statistikor dhe më pas u rakordua me të dhënat nga zyrat e tatimeve në rrethe. Kjo për arsye se në Vjetarin Statistikor të publikuar nga INSTAT këto të dhëna janë të përmbledhura në disa zëra si punime artikuj prej druri, prodhime të letrës etj. Nga grupi i punës është hartuar një pyetësor ku rubrikat e përgatitura dhe të dhënat e kërkuara lejojnë të mblidhet një informacion i mjaftueshëm mbi gjendjen aktuale të këtyre firmave. Pyetësori përfshin një numër pyetjesh të tipit metrik dhe disa pyetje të hapura. Më tej nëpërmjet përpunimit të të dhënave janë nxjerrë dhe një sërë problematikash përgjithësuese. Rubrikat përfshijnë këto aspekte kryesore:

- Të dhëna të përgjithshme mbi biznesin dhe formën ligjore
- Të dhëna për aktivitetin kryesor dhe të tjera
- Materialet dhe lëndët e para që përdoren, kushtet e magazinimit të tyre
- Makineritë që përdoren
- Instrumentet prerëse dhe trajtimi i tyre
- Mënyrat dhe teknikat e tharjes së drurit
- Kushtet e punës dhe ndotja e mjedisit
- Mbetjet teknologjike dhe trajtimi i tyre
- Problemet teknike
- Fuqia punëtore dhe personeli inxhiniero-teknik


- Të dhëna mbi mënyrat e kontrollit të cilësisë
- Të dhëna të marketingut dhe vlerësimi i së ardhmes.

Në materialin e paraqitur jemi fokusuar në disa prej problemeve të cilat prekin disa aspekte të prodhimit siç janë llojet e përpunimit që realizohen, lëndët e para që përdoren, realizimi i prodhimit në tremujorë, shkalla e mekanizimit të operacioneve të transportit, problemet mekanike-elektrike, niveli i kualifikimit të punëtorëve dhe pjesëmarrja e inxhinierëve të specialitetit.


REZULTATET DHE DISKUTIMI

- Shpërndarja dhe forma ligjore e bizneseve të Përpunimit të Drurit të marra në studim


Nga 18 rrethe të marra deri tani në studim janë nxjerrë të dhëna për 49 subjekte. (Të dhënat e paraqitura për Tiranën janë pjesore pasi është menduar të realizohet një studim më specifik). Të dhënat për shpërndarjen e bizneseve jepen në grafikun 1.




Grafiku 1. Shpërndarja e bizneseve sipas rretheve.



Grafiku 2. Klasifikimi i bizneseve sipas aktivitetit kryesor



Grafiku 3. Lëndët e para të përdorura nga bizneset



Grafiku 4. Përqindjet e përdorimit të lëndëve të para

Një e dhënë kryesore e bizneseve është aktiviteti kryesor dhe forma ligjore. Pothuaj të gjitha bizneset e intervistuar përveç aktivitetit kryesor kryejnë dhe aktivitete të tjera të lidhura me atë kryesor. Forma ligjore e tyre është sh.p.k.

- Klasifikimi i bizneseve sipas aktivitetit kryesor

Pavarësisht se në vendin tonë importohet një sasi e madhe artikujsh mobilierie përsëri bie në sy që prodhimi i tyre në rrethet e marra në studim zë një përqindje të rëndësishme. Grafiku 2 tregon se 68% e këtyre bizneseve merret me prodhim mobiliesh, 18% me prodhim të lëndës së sharruar, 10% me prodhim dyer-dritare dhe vetëm 4% me prodhime të tjera.


- Lëndët e para që përdoren

Të gjitha bizneset e prodhimit të lëndës së sharruar përdorin lëndë të parë trupa sharre të siguruar nga pyjet tanë. Prodhimi i mobilie bazohet kryesisht në mobilie me bazë pllaka zdrukthi dhe MDF. Ky është një tregues që tregon se sot struktura e mobilies ka ndryshuar mjaft. Vetëm 14 subjekte përdorin pjesërisht lëndë të parë dërrasë. Përdorimi i lëndës së parë sipas bizneseve jepet në grafikon 3.


Përdorimi i lëndës së parë i shprehur në përqindje paraqitet në grafikon 4.

- Sigurimi lëndës së parë

Nëse para viteve 1990 pothuaj të gjitha lëndët e para ishin vendi, sot raporti ka ndryshuar (grafiku 5). Sigurimi i lëndës së parë i shprehur në përqindje paraqitet në grafikon 6.







Grafiku 5. Sigurimi i lëndëve të para




Grafiku 6. Sigurimi i lëndëve të para në përqindje.

- Ngarkesa e punës së bizneseve sipas tremujorëve

Një vëzhgim i kryer ka të bëjë me ngarkesën në punë gjatë vitit; pra sa pjesë të vitit punojnë subjektet e përpunimit të drurit në Shqipëri. Lidhur me këtë është studiuar ngarkesa sipas tremujorëve për çdo subjekt. Të dhënat shprehen në grafikun 7.



Grafiku 7. Shpërndarja e ngarkesës së punës gjatë vitit.



Grafiku 8. Të dhëna mbi numrin e fuqisë punëtore


- Të dhëna të punësimit

Në grafikun 8 jepen të dhëna të grupuara për numrin e fuqisë punëtore për subjektet e marra në shqyrtim. Bie në sy se 59% e subjekteve kanë 3 deri 10 punëtorë, 23% kanë 11 deri 20 punëtorë dhe vetëm 18% kanë mbi 20 punëtorë.


-Klasifikimi i subjekteve sipas nivelit të mekanizimit të transportit të brendshëm

Një tregues i rëndësishëm i ecurisë së procesit teknologjik dhe krijimit të kushteve të favorshme në punë është dhe mekanizimi i transportit të brendshëm. Transporti i brendshëm në varësi të procesit të punës mund të realizohet thjesht me forcën e krahut, me mjete të thjeshta (karroca dore, transpaleta), me vinça të ndryshëm (pirun, çjap, urë, elektrokarro etj.) me transportierë të

